

Statuti i Iniciativës Balli

Paraqitja

Duke u bazuar në Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës dhe rregullorën e KQZ-së 01/2013 neni 14 subjekti politik Iniciativa Balli paraqet:

Statuti i Iniciativës Balli

Neni 1

Iniciativa BALLI është subjekt politik (person juridik) e cila në kuadër të sistemit politik të Republikës së Kosovës, ne përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e saj duke u bazuar në statutin dhe programin e saj Iniciativa BALLI është parti e spektrit të djatht politik.

Neni 2

Iniciativa Balli angazhohet (vepron) për arritjen e këtyre qëllimeve:

- Angazhohet për zhvillim ekonomik të Republikës së Kosovës.
- Angazhohet për bashkimin e të gjitha forcave shoqërore me orientim nga forcat euroatlantike
- Perpiqet për përmirësimin e gjendjes shoqërore në Republikën e Kosovës.
- Angazhohemi për përmirësimin e sistemit politik
- Angazhohemi për sistemin pliuralist – demokratik.
- Angazhohemi për të drejtat e njeriut dhe avancimin e mëtutjeshem të tyre.
- Angazhohemi për të drejtat e minoriteteve sipas standardeve të bashkësisë ndërkombëtare duke u angazhuar që ti avansojmë edhe më tej.
- Angazhohemi për avansimin dhe zhvillimin e kulturës shqiptare duke ruajtur traditat me te cilat identifikohemi.
- Angazhohemi që ti identifikojmë padrejtësitë shoqërore dhe ti eliminojmë ato.

Neni 3

EMRI, SIGLA, SELIA, EMBLEMA.

Neni 4

Emri i partisë është INICIATIVA BALLI , Sigla është IB.

Neni 5

Selia qendrore e Partisë është Rr. Selim Berisha nr. 26 Prishtinë.

Neni 6

Iniciativa Balli ka vulën e vet e cila ka formën e rumbullakët në qendër është shqiponja partiake, ndërsa në vulë është hapsira në mes dy unazave ku është emërtimi i partisë Iniciativa BALLI-KOSOVË

Neni 7

Iniciativa Balli ka emblemën e saj e cila është vizualisht e paraqitur në KQZ ku figuron shqiponja e partisë dhe emërtimi.

Antarësimi në parti pranimi në parti.

Neni 8

Anëtarë të partisë Iniciativa Balli mund të jenë të gjithë banoret e Kosovës që pranojnë statutin dhe programin, dhe shtetasit e Kosovës që jetojnë në diasporë, dhe te gjithë keta persona duhet të kenë të drejtën e votës në Kosovë , banorët e Kosovës dhe Diasporës.

Në parti nuk mund të pranohen ata persona që janë të ndjekur prej ligjit dhe veprimtari kriminale , personat që kanë kryer vrasje dhe vepra të tjera kundër moralit dhe etikes shoqërore.

Neni 9

Pranimi në parti bëhet në bazë të kërkesës së individit, pas shqyrtimit të kërkesës nga kryesia e degës apo nëndegës ku është paraqitur kërkesa.

Mosha e pranimit është 18 vjeç pavaresisht nga gjendja sociale, gjinore apo fetare.

Neni 10

Antarët e Iniciativa Balli kanë librezën e partisë si dokument antarësimi kudo që ndodhen. Personat që nuk e kanë librezën nuk konsiderohen antarë legjitim të Iniciatives Balli.

Neni 11

Personat e pranuar në parti paguajn antarësin vjetore. Antaresia vjetore është 12 Euro për një vit apo një euro për një muaj. Antarët që deklarohen që nuk kanë mundësi që të paguajn lirohen nga pagesa.

Kush nuk pranohet ne IB

Neni 12

- Ata persona që kanë kryer vepra penale dhe janë nën hetime.
- Ata persona që përhapin ide raciste dhe te urrejtjes.
- Personat që kanë vepruar kundër interesit shtetërorë dhe kombëtar.
- Personat me sjellje të pahijshme shoqërore.

Neni 13

Te drejtat dhe detyrat e antarëve të IB

- Të merë pjesë lirisht në punën e degës apo nëndegës ku është antarësuar, të merr pjesë në diskutime dhe të shfaqë mendimin e tij/saj të zgjedhet në të gjitha organet e partisë.
- Të merr pjesë në të gjitha veprimtarit e IB.
- Të njihet me veprimtarin e organeve drejtuese ne IB
- Të jetë i pranishëm në mbledhje të partisë ku merret vendim në bazën e tij qe ka të bëjë personalisht me të.
- Ti drejtohet organeve të partisë për të mbrojtur të drejtat e tij legjitime.
- Antari i partisë ka të drejt të miret në mbrojtje nga partia kur cenohet, për shkak të veprimtarisë partiake.
- Antari ka të drejtë të informohet për mbledhjet dhe vendimet që marrin organet e partisë.
- Të gjithë antarët e IB janë të barabart në raport me partinë pavaresisht nga funksionet që kanë në parti, gjendjen ekonomike dhe pozicionin shoqëror jasht saj.
- Antarët e IB nuk mund të jenë në asnjë parti tjetër deri sa janë antarë të IB
- Të paguajn antarësinë e IB
- Evidencën e pagesës së antarësisë secila degë dhe nëndegë
- Raportin financiar është e obliguar ta mbaj secila degë dhe nëndegë dhe ta prezantojnë një herë në vit në mbledhjen e antarësisë.
- Të respektoj kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.
- Të respektoj statutin dhe programin e IB.

Humbja e statutit të anëtarit

Neni 14

- Përjashtohet nga partia kur nuk i respekton vendimet e organeve te partisë.
- Kur cenon detyrimet e cekura me këtë statut.
- Kur shpallet fajtorë me vendim te prerë nga gjykata për veprimtari kriminale.
- Kur veprimtaria e tij/saj nuk justifikon qeniën në parti (pasiviteti, mospjesmarrja në mbledhje dhe aktivitete).
- Anëtarit mundet në bazë të vullnetit të tij të lirë në çdo koh të dalë nga partia.
- Ndërprerja e antarësisë mundet të bëhet edhe kur antari punësohet në sektorë ku pjesmarrja ndalohet me ligj.

Procedura e ndërprerjës së antarësisë

Neni 15

- Antarit i tërhiqet vrejttja.
- Shkarkohet nga të gjitha postet.
- Baza e merr vendimin për ndërprerjën e antarësisë me vendim të organit ekzekutiv (kryesia qendrore)
- Organizimimi i partisë strukturat organizative (kryesia qendrore)

Neni 16

Njësia bazë e Iniciatives Balli është nëndega e cila formohet në bazë të vendbanimit, në bazë të fshatit, lagjës. Nëndega duhet të zgjidhë kryetarin, nënkryetarin dhe sekretarin. Numri i antarëve nuk është i kufizuar.

Neni 17

Nëndega perpunon dhe zbaton Politiken e IB, mbanë lidhje me forcat politike dhe organet shtetërore në treritorin që vepron.

Neni 18

Organi më i larte i Nëndegës është Kuvendi i Nëndegës i cili mbahet çdo 4 vite. Në kuvend me vota të fshehta zgjidhet kryesia, kryetari, nënkryetari dhe sekretari. Nëndega mban mbledhje sipas nevojës, mbledhjet i thërret kryetari i nëndegës. Antarët e nëndegës kanë votë të barabartë dhe mundën të ngrejne çështje të ndryshme në mbledhje të nëndegës. Kryetari i jep përgjegjësi organit ekzekutiv të partisë. Antarët e kryesisë të nëndegës mund të zgjidhen në të njëjtin poste vetëm në dy mandate.

Dega e Iniciativa Balli

Neni 19

Dega është përfaqësuesja e partisë dhe në komunë. Dega vendos për qëndrimet e veta në lidhje me problemet locale në komunë.

Këto qëndrime duhet të jenë në përputhje me statutin.

Neni 20

Organi më i lartë i degës është Kuvendi i Degës i cili mbahet çdo katër vite. Në kuvend me vota të fshehta zgjidhet kryesia, kryetari, nënkryetari (sipas nevojës mund të zgjidhen më shumë nënkryetarë) dhe sekretari. Kryesia e degës zbaton Politikën e kryesisë qendrore dhe mirret me probleme në nivel lokal (komunë) dhe mund të marrë vendime të pavarura por në përputhje me statutin. Kryesia bëne ndarjen e punëve për antarë të degës dhe bashkëpunon me forcat politike në nivel lokal, çdo vit paraqet para antarësise raportin financiar në nivel të degës.

Koordinatori i IB

Neni 21

Kryesia e IB mund të zgjedhë koordinatorë për degët e caktuara, në ato degë ku ka probleme, kryesia e prish (rasformon) degen.

- Aty ku nuk ka veprim të degës
- Aty ku nuk zbatohet vija politike e IB
- Moszbatimi i vendimeve të organit ekzekutiv.
- Dhe aty ku do të formohet një degë e re , caktohet koordinatori dhe grupi iniciativ për formimin e degës.

Organet e Iniciatives Balli

Neni 22

Organet e IB janë: Kuvendi, Këshilli Kombëtar, Kryesia Qendrore, Komisioni për kontroll statutarë dhe Komisioni për kontrollë të punës dhe kryesisë.

Kuvendi

Neni 23

Kuvendi është organi më i lartë i IB i cili përfaqëson të gjithë anetarët e partisë dhe shpreh vullnetin e tyre.

Neni 24

Vendimi për thirrjen e Kuvendit , për afatin e mbajtjes, për rregullat e përfaqesimit , mënyrën e zgjedhjes së delegatëve, e merr Keshilli Kombëtarë 2 muaj para mbajtjes së kongresit.

Kuvendi zgjedhë kryetarin e partisë dhe me vota të fshehta miraton statutin dhe dryshimet në statut të IB, miraton programin politik dhe zgjedhë komisionin statutorë dhe komisionin për kontrollë të kryesisë dhe punës së kryetarit.

Neni 24a.

- Kryetari i komisionit financiar çdo vit dorzon pran KQZ-se raportin financiar.
- Komsioni financiar se bashku me komisionin statutar kontrollon shpenzimin e mjeteve financiare nga kryesia e partisë
- Komisioni financiar kontrollon se mjetet a jan shpenzuar për destinime të caktuara sipas destinimit.
- Komisioni financiar paraqet pasqyrën financiare çdo vit para kryesisë së IB
- Komisioni mbanë evidencë për çdo lëvizje financiare.

Komisioni për kontrollë financiare zgjidhet gjat punës së kongresit me vota të hapura apo të fshehta dhe përbehet prej tre anëtareve kryetarit dhe dy anetarëve.

- Komisioni zgjedhet me propozim te delegative te kongresit
- Komisioni merr raportet financiare nga deget çdo muaj.
-

Neni 25

Kuvendi thirret një her në 4 vite.Me vendimin e këshillit Kombëtarë me kerkesën 50%+1 të degëve mund te mbahet Kuvendi i Jashtezakonshem i IB. Kuvendi i Jashtezakonshem thirret ne afat prej 30 ditëve prej marrjes së vendimit .

Neni 26

Kryetari zgjidhet me vota të fshehta.Kryetari mund të zgjidhet vetëm me dy mandate (4+4) 8 vite.kryetarë mund të zgjidhet personi që ka marrë më së shumti vota, prej kandidatëve që kanë konkuruar për kryetarë.

Neni 27

Puna e Kuvendit dhe vendimet qe i ka marrë Kuvendi quhen të ligjshme në qoftëse në kongres marrin pjesë 50%+1 të delegatëve.

Neni 28

Çdo degë mund të delegoi në Kongres 4 deri 7 delegat të zgjedhur në kuvend të degës plus antarët e kryesisë qëndrore dhe antarët e Këshillit Kombëtar.

Këshilli Kombëtarë

Këshilli Kombëtarë përbehet nga kryetarët e degëve të IB nga deputetet që janë zgjedhur në kuvend komunale dhe Kuvend të Kosovës, nga ministrat e zgjedhur të IB, dhe perfaqësues të degëve të

zgjedhur nga diaspora, mbledhjet dhe veprimtaria e këshillit Kombëtarë drejtohet nga Kryetari i partisë dhe kryesia të cilët janë po ashtu anëtarë të këshillit Kombëtare.

Neni 29

Këshilli kombëtarë zbaton vendimet e Kuvendit , zbaton politikat e përcaktuara nga Kuvendi dhe jetëson punën e Komisionit Statutar dhe Komisionit për Kontroll të Punës së Kryetarit të Kryesisë së IB.

Neni 30

Këshilli Kombëtar konvokohet me thirrje të Kryetarit. Në mbledhjen e parë pas Kongresit me propozim të Kryetarit të Këshillit Kombëtar zgjedh kryesin e partisë. Në qoftë se Nënkryetari apo Sekretari nuk zbaton politikat e IB apo nuk vepron, kohë të gjatë , apo kryenë vepër penale, këshilli Kombëtar me 50% + 1 të antarëve mundet me kerku votëbesim për këta persona. Votëbesimi bëhet me vota të fshehta, Këshilli Kombëtar mundet në çdo kohë me kerku raportin financiare nga Kryetari dhe Kryesia, që të japin përgjegjesi para këtij organi, Këshilli Kombëtar vlerëson punën e Kryesisë, sygjeron dhe aplikon politikat e përcaktuara nga Kongresi. Miraton veprimet e propozuara nga kryetari i IB.

Kryetari i Partisë

Neni 31

Kryetari i Partisë zgjidhet si kandidat në mes dy apo me tepër kandidatëve që ka fituar më shumë vota të pjesmarrësve të Kongresit.

Neni 32

Kryetari i IB ka të drejtën e propozimit të antarëve të Kryesisë, të nënkryetarëve, Sekretarit të Përgjithshëm dhe sekretarë të ndryshëm, Në mbledhjen e parë të Këshillit Kombëtar, Kryetari jep propozimin për Kryesi te Re-Këshllit Kombëtar e aprovon në tërësi apo jep vërejtje dhe sygjerime për ndryshime të Kryesisë.

Neni 33

Kryetari i IB ka të drejtën që me mbështetjen e 50%+1 të antarëve të Këshillit Kombëtar të thërret kongres të jashtëzakonshëm.

Neni 34

Kryetari i IB përfaqëson dhe drejton veprimet politike në përputhje me vendimet e Kuvendit , zbaton vendimet e këshillit Kombëtar dhe Kryesisë Qëndrore, emëron dhe shkarkon çdo punonjës nëpër qendër dhe baza (zyre). Konstituon departamente, zyra, organizon punën e tyre në koordinim me kryesin cakton personat të cilët paraqitën publikisht në emër të IB.

Organizon punën në parti , angazhon antarët e kryesisë dhe funksionarët tjerë me punën praktike (cakton detyrat) kujdeset për mbarvajtjen e punës së IB.

Kryetari zgjidhet çdo 4 vite me mundësi zgjedhjeje edhe për 4 vite(pra dy mandate).

Kryesia e IB

Neni 35

Oragni ekzekutiv i IB dhe Këshilli Kombëtar është kryesia e IB dhe në mes dy Kuvendeve dhe mbledhjeve të Këshillit Kombëtar është organ drejtues.

Kryesia e IB mblidhet një herë në muaj me thirrje të kryetarit (në mungesë të kryetarit kryesin mund ta thirrë Nënkryetari i parë apo sekretari).

Kryesia zbaton vendimet e Kuvendit dhe Këshillit Kombëtar, harton projekte të bugjetit vjetor, përgadit materialet për diskutim në mbledhje.

Në emër të partisë bën marrëveshje me forcat e tjera politike dhe siguron veprimet organizative, kryen të gjitha punët administrative të parapara me ligj si pasqyrë financiare dhe listen e azhurimit.

Neni 36

Vendimet e kryesisë së IB janë të ligjshme kur në votim marrin pjesë me shumë se 50% e antarëve.

Neni 37

Kryesia vendos për bashkëpunim me shoqata, formon strategjit elektorale, listat e kandidatëve, listat e kandidatëve për zgjedhje, merr vendime për qështje politike, vendosë për koalicione, shkrirje apo Bashkim me subjekte tjera politike, të gjitha këto veprime i merr sipas koordinimit mes Kryetarit dhe Kryesisë.

Neni 38

- Kryetari
- Nënkryetari i parë
- Nënkryetari i dytë
- Sekretari i përgjithshëm
- Sekretari organizativ
- Sekretari për Marrëdhënie me Publikun
- Sekretari për Marrëdhënie me Botën e Jashtme
- Kryesia është Organ Ekzekutiv i Partisë
- Komisioni Statutar.

Neni 39

Komisioni statutar përbehet prej 3 antarëve.

Komisioni zgjedhet gjatë punës së Kongresit me propozim të delegatëve të Kongresit me vota të hapura dhe të fshehta.

Komisioni kontrollon zbatimin e statutit të IB , kontrollon kërkesat dhe Ankesat që ju drejtohen organeve qëndrore .

Në rast të kontestit të krijuar nga interpretimi i komisionit statutar apo kërkesa e ndonjë antari të IB për interpretim të statutit, mund të krijohet nga kryesia e IB një komision nga tre antar AD HOK për zgjedhjen e ati rasti.

Vendimi i komisionit është obligative për personat që kan ngrit qështjen e interesimit të statutit.

- Kontrollon si po zhpenzohen mjetet financiare nga kryetari dhe kryesia.
- Propozon ndryshimet në statut.
- Komisioni për kontrollë të ës së kryetarit dhe kryesisë.

Neni 40

Komisioni për kontroll të punës së kryetarit dhe kryesisë ërbehet prej 3 antarëve.

- Komisioni zgjdhet gjatë punës së kongresit me propozim të delegatëve dhe kongresit me vota te hapura apo te fshehta.
- Komisioni i kontrollit kontrollon punën e kryetarit dhe kryesise.
- Kontrollon ligjshmerine e vendimeve të kryesisë.
- Komisioni ka te drejtë të propozoj që çdo anetar të kryesisë të shkoj në votë besim në Këshillin Kombëtar në qofte se vlerëson se nuk i kanë kryer detyrat e caktuara nga Kongresi dhe Këshilli Kombëtar.
- Komisioni mund të kontrolloj së bashku me komisionin statutar shpenzimet e mjeteve financiare nga kryesia
- Kontrollon Ankesat dhe vendimet për perjashtim nga partia dhe jep vlerësimet e veta a jan te ligjshme.

Neni 41

Në IB preferohet 50% të antarëve të jenë të gjinisë femrore, gjithashtu preferohet që në organet e parties 50% femra dhe sa ma shumë rini.

Bashkëpunimi me partitë dhe shoqatat.

Neni 42

IB bashkëpunon me të gjitha partite politike që kanë orientim të njëjtë me IB.

Bashkëpunon edhe me shoqata politike dhe OJQ dhe forume të ndryshme qv kanë qëllime të ngjajshme.

IB nuk bashkëpunon me ato parti dhe organizata të cilat cenojnë interesin shtetëror dhe integritetin Kombëtar.

Mjete e informimit

Neni 43

IB është e hapur ndaj mjeteve të informimit dhe e ruajn të drejten me qenë të lirë në dhenjen e informacioneve dhe shprehjen e lirë sipas ligjeve të Kosovës.

Mjetet financiare

Neni 44

Te ardhurat financiare të IB përbëhen:

- Antarësia e partisë
- Donacione
- Kontribute vullnetare
- Të hyrat nga buxheti i Kosovës sipas ligjit mbi financimin e partive politike.

Neni 45

Financat dhe buxheti vjetor miratohet nga Këshilli Kombëtar.

Neni 46

Për kontroll financiarë në nivel qendror dhe lokal janë ngarkuar Komisioni Statutar dhe Komisioni i Kontrollit të Kryesisë.

Në rast të shuarjes së partisë këto komisione disponojnë me mjete financiare të partisë dhe i orjentojnë mjetet sipas dispozitave në fuqi.

Dispozitat perfundimtare

Neni 47

Statuti i partisë dhe programi janë të hapur për ndryshime në përputhje me ligjin.

Neni 48

Iniciativa Balli është person Juridik.

Neni 49

Veprimtaria e Inicatives Balli mund të ndërpritet, shuhet me referendum mbrenda partisë me 2/3 e votave të antarëve dhe miratohet për shuarje.

Veprimtaria mund të shuhet edhe sipas forcës së ligjit.

Neni 50

Ky Statut hyn në fuqi pas aprovimitë Kuvend.

Data e Aprovimit

Kryetari
